

4458/8

19.06.2015



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr.8957 (31010-02695-86-2015) Rregj.Them.  
Data Regjistrimi 27.04.2015

Nr. 1168 (112) Vendimi  
Datë 28.05.2015

V E N D I M  
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit, e përbërë prej :

GJYQTAR - Kastriot SELITA  
GJYQTAR - Altina NASUFI  
GJYQTAR - Rilinda SELIMI

Asistuar nga sekretarja gjyqësore Valbona Zenelaj, në Tiranë, sot me datë 28.05.2015, shqyrtoi në dhomë këshillimi çështjen administrative me palë :

PADITËS: Shoqëria "Renaldo" sh.p.k me seli Ura Vajgurore, Berat.

TË PADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Berat.  
Drejtoria e Apelimit Tatimor, Tiranë.

Person i tretë: Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Vlorë.

OBJEKTI: Shfuqizimin e aktit administrativ "Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore" nr. 662 Prot. Datë 26.02.2014 të DRT Berat.  
Vendim i Drejtorisë së Apelimit Tatimor nr. 7186/3 Prot. datë 06.06.2014 për lënien në fuqi të njoftim vlerësimeve për njoftim vlerësimin tatimor të DRT Berat nr. 662 Prot. datë 26.01.2014.  
Marrjen e masës së sigurimit të padisë atë të pezullimit të ekzekutimit të detyrimit në bazë të Njoftim vlerësimit për detyrimet tatimore të DRT Berat dhe të DAT Tiranë deri në përfundim të procesit gjyqësor.

BAZA LIGJORE: Nenet 2,7,11,15 e vijues të ligji nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", nenet 115,116,117, 118 e vijues të K. Pr. Administrative, ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë me vendimin nr. 1785, datë 01.12.2014 ka vendosur :

1. "Pranimin e kërkesë padisë si të bazuar në prova dhe në ligj.
2. Shfuqizimin e aktit administrativ: Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr. 662 Prot. Datë 26.02.2014 të DRT Berat.
3. Shfuqizimin e vendimit të Drejtorisë së Apelimit Tatimore nr. 7186/3 Prot. Datë 06.06.2014 për lënien në fuqi të njoftim vlerësimeve për njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore të DRT Berat nr. 662 Prot. datë 26.02.2014.
4. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.
5. Ndaj këtij vendimi nuk nxirret urdhër ekzekutimi.

Urdhërohet Zyra e Përmbarimit me ekzekutimin e këtij vendimi menjëherë apo vendimi të marrë formë të prerë"

Kundër këtij vendimi të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë kanë paraqitur ankim pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Berat (DRT Berat) dhe Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Vlorë duke parashtruar shkaqet si më poshtë vijon:

1. *DRT Berat ka zbatuar procedurën e vlerësimit tatimore sipas mënyrave alternative të vlerësimit referuar nenit 72 të ligjit nr. 9920/2008, duke vepruar në rastin konkret në bazë të tē dhënavë tē vëna në dispozicion nga palët e tre, konkretisht informacionit të ardhur nga Policia Gjyqësore Berat.*
2. *Në bazë tē këtij informacioni pasi janë kryer verifikimet e nevojshme në lidhje me deklarimin ose jo tē punëmarrësve tē konstatuar në punë në momentin e kontrollit, është marrë miratimi nga Drejtori i DRT Berat për vlerësimin alternativ sipas shkresës nr. 321 Prot. datë 13.12.2014.*
3. *Nga verifikimi ka rezultuar se shoqëria paditëse nuk ka bërë asnjë lloj deklarimi për personat e konstatuar nga policia në momentin e kontrollit.*
4. *Akti administrativ-njoftim vlerësimi tatimore është i bazuar në ligjin nr. 9920/2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, konkretisht nen 119, pika 1, gërmë "b".*
5. *Gjykata ka argumentuar në mënyrë tē gabuar duke konstatuar pavlefshmërinë absolute tē aktit administrativ-njoftim vlerësimi tatimore tē DRT Berat. Në rastin konkret akti administrativ i DRT Berat nuk plotëson asnjë nga kriteret e përcaktuara në nenin 116 tē K.Pr.Administrative, në mënyrë që tē konstatohet nga gjykata si akt absolutisht i pavlefshëm.*

Sa sipër pala e paditur dhe Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Vlorë kërkojnë ndryshimin e vendimit Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe rrëzimin e kërkesë padisë së shoqërisë "Renaldo" sh.p.k.

Gjykata Administrative e Apelit, pasi e shqyrtoi çështjen në dhomë këshillimi, dëgjoi relacionin e përgatitur nga gjyqtari relator, si dhe analizoi shkaqet e ngritura në ankim, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 49/2012, në këndvështrim me kërkesat e ligjit material dhe procedural,

## VËREN

Pala paditëse i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me kërkesë padi duke kérkuar:

Shfuqizimin e aktit administrativ "Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore" nr. 662 Prot. datë 26.02.2014 të DRT Berat. Vendim i Drejtorisë së Apelimit Tatimor nr. 7186/3 Prot. datë 06.06.2014 për lënien në fuqi të njoftim vlerësimeve për njoftim vlerësimin tatimor të DRT Berat nr. 662 Prot. datë 26.01.2014. Marrjen e masës së sigurimit të padisë atë të pezullimit të ekzekutimit të detyrimit në bazë të Njoftim vlerësimit për detyrimet tatimore të DRT Berat dhe të DAT Tiranë deri në përfundim të procesit gjyqësor.

Pala paditëse në lidhje me këto kërkime i ka referuar si bazë ligjore në nenet 2,7,11,15 e vijues të ligji nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", nenet 115,116,117, 118 e vijues të K. Pr. Administrative, ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë në përfundim të shqyrimit gjyqësor të çështjes me vendimin nr. 1785, datë 01.12.2014, ka vendosur pranimin e kërkesë padisë së shoqërisë paditëse "Renaldo" sh.p.k si të bazuar në ligj e në prova.

Kundër këtij vendimi të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë ka bërë ankım pala e paditur DRT Berat dhe Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Vlorë.

Konstatohet se ankimet e paraqitura nga pala e paditur dhe Avokatura e Shtetit janë përcjellë në Gjykatën Administrative të Apelit, duke u verifikuar kushtet e pranueshmërisë së tyre, e përrnjedhojë, janë shoqëruar me vendimin e gjyqtarit që ka pranuar ankimet. Në këto rrethana gjykata e shqyrtoi çështjen administrative të paraqitur nëpërmjet këtyre ankimeve në dhomë këshillimi sipas përcaktimeve të nenit 49/1 të ligjit nr. 49/2012.

### *Rrethanat e çështjes*

Nga aktet e dosjes gjyqësore të përcjella me ankimin kundër vendimit nr. 1785, datë 01.12.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë rezulton se:

Shoqëria "Renaldo" sh.p.k është një shoqëri tregtare e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ushtron aktivitet nxjerrje guri në fshatin Konizbalt, Berat. Drejtoria e Policisë së Qarkut Berat ka ushtruall kontroll pranë këtij subjekti në datën 28 Janar 2014 për punësim të paligjshëm. Gjatë kontrollit të kryer ka rezultuar se janë gjetur tre punonjës që punonin pranë këtij subjekti të pasiguruar. Për dokumentimin e kontrollit është mbajtur procesverbal i konstatimit i datës 28.01.2014, si dhe janë pyetur tre punonjësit duke i dokumentuar deklarimet e tyre në procecvale respektive "Për marrjen e të dhënavë nga personi që ka dijeni për veprën penale". Sipas këtyre procesverbaleve të tre personat kanë deklaruar se punojnë pranë shoqërisë-puditëse. Drejtoria e Policisë së Qarkut Berat i ka dërguar këto procecvale palës së paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Berat (DRT Berat) me shkresën nr. 375 Prot. datë 30.01.2014. Drejtori i DRT Berat ka miratuar kërkesën për miratim vlerësimi tatimor nr. 321 Prot. datë 13.02.2014 të paraqitur nga inspektori i vlerësimit tatimor, për miratimin e vlerësimit tatimor në shumën 1.500.000 lekë për shoqërinë "Renaldo" sh.p.k si gjobë për punonjës të pasiguruar, bazuar në

informacionin e sjellë nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Berat me shkresën nr. 375 Prot. Datë 13.02.2014. Bzuar në këtë vlerësim tatimor pala e paditur DRT Berat ka nxjerrë Njoftimin e vlerësimin e detyrimeve tatimore nr. 662 prot. datë 26.02.2014 me anë të cilit ka gjobitur shoqërinë paditëse në shumën 1.500.000 lekë bazuar në nenin 119 të ligjit nr. 9920/2008.

Pala paditëse ka ushtruar të drejtën e ankimit administrativ pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimore Tiranë (DAT Tiranë), e cila me vendimin nr. 7186/3 Prot. datë 06.06.2014 ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit objekt ankimi, Njoftim për vlerësimi për detyrimet tatimore nr. 662 Prot. datë 26.02.2014 të DRT Berat për detyrim me gjobë për punëmarrësit e padekluarar në shumën 1.500.000 lekë dhe rrëzimin e ankimit”.

Në vendimin e saj DAT Tiranë ka argumentuar se njoftim vlerësimi tatimor i DRT Berat është i bazuar në të dhëna të vëna në dispozicion nga palë të tretë (informacioni i ardhur nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Berat) bazuar në nenin 72 të ligjit nr. 9920/2008. Gjithashtu nga verifikimi i DRT Berat rezulton se tre personat e gjetur në ambjentet e shoqërisë paditëse nuk rezulton të jenë dekluarar si të punësuar nga shoqëria “Renaldo”sh.p.k. Për rrjedhojë akti administrativ i DRT Berat është i bazuar në nenin 119 të ligjit nr. 9920/2008.

Në këto kushte pala paditëse i është drejtuar në datën 27.06.2014 Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me kërkësë padinë me objekt, palë të paditur dhe bazë ligjore siç përshkruhet në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë me vendimin nr. 1785, datë 01.12.2014 ka vendosur pranimin e padisë së shoqërisë “Renaldo”sh.p.k si të bazuar në ligj e në prova.

Nga përbajtja e vendimit nr. 1785 të datës 01.12.2014 të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Vlorë rezulton se gjykata e shkallës së parë ka arritur në këtë zgjidhje me arsyetimin e mëposhtëm:

1. Gjatë gjykimit u vërtetua fakti se nuk është e vërtetë që pala paditëse ka punësuar tre shtetas në mënyrë të paligjshme, pasi në momentin e kontrollit nga punonjësit e policisë së Drejtorisë së Policisë së Qarkut Berat, këta shtetas ndodheshin aty në mënyrë të rastësishme.
2. Gjykata çmon se në nenin 119 të ligjit nr. 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore” thuhet qartë se për tatimpaguesin punëdhënës, i cili nuk ka dekluarar të punësuar gjobitet me 500.000 lekë. Në rastin konkret subjekti “Renaldo” sh.p.k është gjobitur në masën 1.500.000 lekë, shumë që është tepër e madhe në krahasim me ligjin nr. 9920/2008 i ndryshuar. Për këtë fakt akti administrativ-vendimi nr. 7186/3 Prot. datë 06.06.2014 i DAT Tiranë duhet të shfuqizohet dhe Gjykata të konstatojë pavlefshëmrinë absolute të aktit administrativ.
3. Gjykata konstaton se DRT Berat nuk ka bërë aktin e konstatimit në vend në ambjentet e shoqërisë paditëse, por inspektori i cili ka ndjekur praktikën e paditësit është mjaftuar me një raport shërbimi të inspektorit të policisë së zonës. Pra në këtë rast nuk është zbatuar procedura e vënies së gjobës.
4. Gjatë gjykimit u provua fakti se në momentin që oficerët e policisë gjyqësore kanë pyetur tre shtetasit e mësipërm, këta të fundit nga frika kanë dekluarar se punonin në këtë subjekt.

5. Gjatë gjykimit u vërtetua fakti se ky subjekt ka tre muaj që për këtë fakt nuk ushtron aktivitetin e tij.

Gjykata Administrative e Apelit e shqyrtoi ankimin në dhomë këshillimi duke analizuar tërësinë e rrethanave faktike në referim të përcaktimeve të ligjit të zbatueshëm në rastin konkret.

#### Vlerësimi i gjykatës

Në analizë të ankimit dhe shkaqeve të ngritura nëpërmjet tij, të vendimit objekt ankimi, të akteve të dosjes si dhe në referim të përcaktimeve të ligjit të posaçëm dhe atij procedural që gjejnë zbatim në rastin konkret, Gjykata Administrative e Apelit çmon se: Vendimi nr. 1785, datë 01.12.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë është marrë në interpretim të gabuar të ligjit dhe si i tillë duhet të ndryshohet dhe padia e shoqërisë "Renaldo" sh.p.k duhet të rrëzohet si e pabazuar në prova dhe në ligj.

Shoqëria "Renaldo" sh.p.k ushtron aktivitet ushtron aktivitet nxjerrje guri në fshatin Konizbalt të Qarkut Berat. Drejtoria e Policisë së Qarkut Berat ka ushtruall kontroll pranë këtij subjekti në datën 28 Janar 2014 për punësim të paligjshëm. Gjatë kontrollit të kryer ka rezultuar se janë gjetur tre punonjës që punonin pranë këtij subjekti të pasiguruar. Këta punonjës kanë deklaruar përpara oficerëve të policisë gjyqësore se punojnë si punëtor të palës paditëse. Drejtoria e Policisë së Qarkut Berat në lidhje me këtë konstatim ka njoftuar palëne paditur DRT Berat. Inspektori i vlerësimit të DRT Berat pasi ka konstatuar se këta tre shtetas nuk janë deklaruar si të punëuar pranë palës paditëse i ka kërkuar Drejtorit të DRT Berat miratimin e vlerësimit tatimor ndaj palës paditëse për periudhën tatimore Janar 2014 për punonjës të padeklaruar, lidhur me konstatimin e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Berat. Në këto kushte DRT Berat me aktin administrativ-njoftim vlerësimin për detyrimet tatimore nr. 662 Prot. datë 26.02.2014 ka vendosur të gjobisë shoqërinë "Renaldo" sh.p.k me gjobë në shumën 1.500.000 lekë.

Shoqëria Paditëse ka ushtruar të drejtën e ankimit sipas ligjit dhe pasi ka shteruar rrugën administrative të ankimit përpara Drejtorisë së Apelimit Tatimor i është drejtuar gjykatës duke pretenduar pavlefshmërinë absolute të akteve administrative, si pasojë e shkeljes flagrante të ligjit nga pala e paditur në caktimin e masës së gjobës ndaj palës paditëse.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë me vendimin objekt ankimi e ka pranuar padinë e ngritur nga pala paditëse sipas objektit të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi me argumentin se jemi përpara rastit të pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, pasi pala e paditur nuk ka zbatuar procedurën e përcaktuar në ligj përvendosjen e gjobës, si dhe masa e gjobës së vënë ndaj palës paditëse nuk është në përpunë me ligjin.

Ky vlerësim i gjykatës së shkallës së parë rezulton të jetë i gabuar dhe jo në përpunë me rrrethanat e faktit të vërtetuara në gjykim si dhe me përcaktimet e ligjit.

Gjykata Administrative e Apelit çmon se në rastin objekt gjykimi aktet administrative të kundërshtuara nga pala paditëse nuk janë absolutisht të pavlefshme sipas përcaktimeve të nenit 116 të K. Pr. Administrative.

Neni 116 i K.Pr. Administrative përcakton se:

*"Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme, në*

*kuptimin e këtij Kodi, në rastet e mëposhtme:*

- a) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i pidentifikuar;
- b) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore;
- c) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji".

Rezulton se këto akte janë nxjerrë nga pala e paditur në formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji dhe në ushtrim të kompetencave dhe autoritetit të dhënë nga ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 24, datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore".

Gjykata Administrative e Apelit çmon të bazuar pretendimin e ngritur nga palët e paditura në ankimin në rastin objekt gjykimi, se: DRT Berat ka zbatuar procedurën në lidhje me marrjen e masës administrative ndaj shoqërisë paditëse. Rezulton se DRT Berat në rastin konkret ka proceduar në marrjen e masës administrative ndaj palës paditëse, bazuar në ligjin nr. 9920/2008 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 24/2008 dhe konkretisht pikën 72/1 të tij. Pala e paditur rezulton se e ka marrë masën administrative ndaj paditësit bazuar në "Të dhëna direkte, dokumentacione e informacione të marra nga palët e treta". Konkretisht akti administrativ i palës së paditur është bazuar në kontollin dhe aktet e konstatimit të dërguara kësaj të fundit nga palët e treta-Drejtoria e Policisë së Qarkut Berat. Inspektorit i vlerësimit pranë DRT Berat ka kryer vlerësimin bazuar në dispozitën ligjore të sipërcituar dhe ka marrë miratimin e Drejtorit të DRT Berat, duke respektuar në këtë mënyrë procedurën e kërkuar nga ligji. Gjithashtu akti administrativ-njoftim vlerësimi tatimor i DRT Berat i është njoftuar rregullisht shoqërisë paditëse.

Gjithashtu me të drejtë pala e paditur ka pretenduar në ankimin e saj se masa administrative e marrë ndaj palës paditëse është e bazuar në ligj e në prova. Rezulton se masa administrative e marrë nga pala e paditur ndaj palës paditëse është bazuar në shkeljen e ligjit nr. 9920/2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë". Konkretisht nen 119, pika 1 gërmë "b" i këtij ligji përcakton se:

*"Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendodhjen e biznesit, rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor cdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike para fillimit të punës, përvec detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributive të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të llogaritura nga data e konstatimit, dënohet me gjobë për cdo punonjës të padekluar si më poshtë:*

- a) *tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, gjobë prej 500 000 (pesëqind mijë) lekësh,*
- b) *Tatimpaguesit e tjerë me gjobë prej 250.000 lekësh..."*

Rezulton e provuar nga aktet e paraqitura se pala paditëse nuk ka respektuar detyrimin ligjor të përcaktuar në dispozitën e sipërcituar për deklarimin e punonjësve të punësuar rishtazi të paktën një ditë kalendarike para fillimit të punës. Gjithashtu pretendimi i palës paditëse se tre shtetasit e konstatuar në ambientet e saj në momentin e kontrollit nga oficerët e policisë gjyqësore të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Berat, nuk kanë qenë punonjës të(saj) subjektit, është një pretendim i pabazuar, pasi të tre këta shtetas kanë deklaruar përpara oficerëve të policisë gjyqësore se punojnë pranë palës paditëse dhe kryejnë punë të ndryshme.

Sipas përcaktimeve të ligjit(dispozitës së cituar më sipër) rezulton se për çdo punonjës të padëkluar tatimpaguesit i caktohet gjobë në shumën 500.000 lekë. Në kushtet në të cilat ka rezultuar se tatimpaguesi ka patur 3 punonjës të padëkluar, me të drejtë është caktuar nga pala e paditur gjoba në shumën 1500.000 lekë. Për rrjetohojë konkluzioni i gjykatës së shkallës së parë se masa e gjobës së vënë palës paditëse nga DRT Berat është më e madhe se përcaktimet e ligjit nr. 9920/2008, është një konkluzion i gabuar dhe që është në kundërshtim me rrethanat e faktit që kanë rezultuar të provuara në gjykim.

Në rrethanat e përshkruara sa më sipër Gjykata Administrative e Apelit bazuar në nenin 50 gërmë "c" të ligjit Nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave Administrative dhe gjykinin e mosmarrëveshjeve administrative", vlerëson se vendimi nr.1785, datë 01.12.2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë duhet të ndryshohet dhe kërkesë padia e shoqërisë "Renaldo" sh.p.k duhet të rrëzohet si e pabuar në ligj e në prova,

**PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Administrative e Apelit, në mbështetje të neneve 50 gërmë "c" dhe 56, të ligjit Nr. 49/2012 "Për organizimin edhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykinin e mosmarrëveshjeve administrative",

**VENDOSI**

1. Ndryshim e vendimit nr. 1785 datë 01.12.2014 të Gjykatës Adminisitrative te Shkalles se Pare Vlorë.
2. Rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj.
3. Shpenzime gjyqësore nuk ka.
4. Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve duke filluar ky afat nga dita e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë sot më datë 28.05.2015

GJYQTAR  
Rilinda SELIMI

d.v

GJYQTAR  
Altina NASUFI

d.v

GJYQTAR  
Kastriot SELITA

d.v

Vertetohet njesia me origjinalin

Kancelori  
Leonard Steaty  
